



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 197, Datë 15.08.2025

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “KËLCYRA 2020” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KLISYRË”, ME KAPACITET PRODHUES 2 MW

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38 pika 1, gërma “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.08.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2038/8 prot., datë 11.08.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “KËLCYRA 2020” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “KËLCYRA 2020” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2038 prot., datë 08.07.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Klisyrë”, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale 2170, nr. pasurie 1071, Klisyrë, Tropojë.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 152, datë 17.07.2025 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “KËLCYRA 2020” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 18.07.2025 dhe 19.07.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 28.07.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën me nr. 2038/3 prot., datë 23.07.2025, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e sipërcituar dhe i ka evidentuar informacionin/dokumentacionin e munguar për këtë aplikim.
- Gjithashtu, me shkresën nr. 2038/4 prot, datë 23.07.2025, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nga e cila nuk ka pasur një përgjigje.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2038/5 prot., datë 29.07.2025, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar i nevojshëm zhvillimi i një komunikimi të mëtijshëm me shoqërinë në lidhje me aplikimin e saj për shtesën e fuqisë në lejen e përdorimit të burimit ujqor, në 2 MW, afatin brenda të cilit parashikon të pajiset me këtë leje, si dhe për depozitimin e një informacioni/argumentimi teknik ku është bazuar rritja e kapacitetit të instaluar të HEC-it nga 15 në 2 000 kW.
- Në përgjigje, me e-mailin e datës 08.08.2025, protokolluar në ERE me nr. 2038/7 prot., datë 11.08.2025, shoqëria ka depozituar informacion plotësues të aplikimit.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime te tjera:

- Shoqëria “KËLCYRA 2020” sh.p.k. ka në pronësi HEC “Klisyrë”, sipas *Kontratë shitje pasuri e paluajtshme*, nr. 2116 rep., nr. 870 kol., datë 16.12.2020 të nënshkruar me shoqërinë “PETROL ALBA” sh.a., në cilësinë e shitësit.
- Shoqëria është pajisur me Leje për përdorimin e Burimit Ujqor sipërfaqësor nr. 395 prot., datë 11.10.2024, e lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujqor (KBU) Drin-Bunë, me nr. Serial 000212, e miratuar me Vendim e KBU Drin-Bunë nr. 17, datë 08.10.2024, për kapacitetin 15 kW. Në datën 23.07.2025 shoqëria ka bërë aplikim pranë AMBU për shtim të kapacitetit në 2 MW.
- Shoqëria ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së HEC-it me rrjetin e shpërndarjes përmes shkresës së OSSH sh.a. nr. 1424/3 prot., datë 22.08.2022.
- Me shkresën nr. 110/1 prot., datë 13.01.2021 “*Mbi procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)*”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) ndër të tjera është shprehur se, “...Për nga pikëpamja mjedisore nuk kemi shtrirje në zona të reja, ndryshim kuote, prekje të sipërfaqeve të tjera, zgjerime, por vetëm rikonstruksione të lehta në objektin e ndërtuar, si e tillë, ky projekt nuk duhet t’i nënshtrohet procedurave të VNM-së.”

Kushtet dhe Afatet Ligjore:

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “*Për sektorin e energjisë elektrike*”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, ndaj dhe licenca e shoqërisë do të jetë për 30 vjet.
- Me e-mailin e datës 08.08.2025, shoqëria ka informuar se aplikimi për pajisjen me lejen e përdorimit të burimit ujqor për kapacitetin 2 MW është kryer në datën 23.07.2025, dokument me të cilin, sipas afateve ligjore, shoqëria parashikon që të pajiset brenda muajit shtator 2025. Duke qenë se licenca e prodhimit nga ERE është dokument i rëndësishëm që kërkohet për procedurat e zhdoganimit të pajisjeve si dhe për procesin e aplikimit për financim pranë institucionit bankar, shoqëria ka kërkuar nga ERE që të merret në konsideratë mundësia e lëshimit të licencës me kusht, sipas fuqisë së kërkuar nga ana e shoqërisë, duke marrë angazhimin për të depozituar në ERE lejen e përditësuar të përdorimit të burimit ujqor me fuqinë e re të instaluar 2000 kWh, menjëherë sapo të pajiset me të.

- Në rrethanat kur shoqëria ka dokumentuar në ERE aplikimin për rritjen e kapacitetit të lejes së përdorimit të burimit ujqor, dhe në rrethanat kur ka plotësuar dokumentacionin tjetër të këtij aplikimi, vlerësohet që të vijohet me licencimin e shoqërisë, me kusht që përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, ajo të depozitojë në ERE lejen e përditësuar të përdorimit të burimit ujqor, sipas kapacitetit për të cilin ka aplikuar në ERE, pra për 2 MW.
- Në kuadër të këtij aplikimi, shoqëria ka përcjellë në ERE, shkresën nr. 110/1 prot., datë 13.01.2021 të AKM-së, drejtuar shoqërisë “KËLCYRA 2020” sh.p.k., në të cilën përcaktohet se në rrethanat ku *qëllimi i blerjes së objektit nga ana e shoqërisë është rivënia në punë e veprës ekzistuese dhe për këtë arsye do të kryhen këto punime: Rikonstrukcion i tubit dhe i kanalit, rikonstrukcion i veprës së marrjes dhe rikonstrukcion i godinës ekzistuese të HEC-it, ndërhyrje të cilat do të kryhen në godinën e HEC-it, pa ndërhyrje në kuotat e marrjes së ujit, sipërfaqe, gjatësi, ndryshim të rrjedhës së ujit, shtrirje në zona të reja, hapje themelesh etj. si e tillë, ky projekt nuk duhet ti nënshtrohet procedurave të VNM-së,*
- Për sa më lart përcaktuar, vlerësohet se, me depozitim të lejes së përdorimit të burimit ujqor të ndryshuar nga ana e shoqërisë, do të analizohet në rast se ERE është në të njëjtat rrethana për sa përcaktuar në shkresën e AKM-së apo do të lindë nevojë për të marrë një qëndrim nga ana e kësaj të fundit.
- Sa parashikuar nga ana e shoqërisë, që Hec-i do të fillojë operimin brenda muajit dhjetor, vlerësohet të pasqyrohet dhe në dispozitivin e vendimit, duke i lënë detyrë shoqërisë gjithashtu, që me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.
- Rezulton se aktualisht shoqëria ka në dispozicion të gjithë stafin e nevojshëm për operimin e centralit, por marrëveshja e shërbimit të jashtëm për kontabilitetin nuk mbulon të gjithë periudhën 30-vjecare të licencimit, ndaj vlerësohet që brenda afatit të përfundimit të saj, pra brenda datës 01.01.2026, t’i lihet detyrë shoqërisë që të depozitojë në ERE marrëveshjen e rinovuar.
- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “KËLCYRA 2020” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Klisyrë”, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale 2170, nr. pasurie 1071, Klisyrë, Tropojë, për një afat 30-vjeçar.
2. Përpara fillimit të operimit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Klisyrë”, për kapacitetin 2 MW.

3. Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE ndërtimin dhe vënien në punë të HEC-it brenda datës 31.12.2025.
4. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.
5. Brenda datës 01.01.2026, shoqëria duhet të depozitojë marrëveshjen e rinovuar për shërbimet e kontabilitetit.
6. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.
7. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “KËLCYRA 2020” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSSH sh.a., dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI